VIDEO/ I riu doli në ballkon për të pirë cigare, por u qëllua për vdekje nga një distancë e afërt. Si u eliminua me 1 plumb në kokë nga snajperisti

08 Janar, 2024 08:46



Madhësia e tekstit:

Pamjet që shihni tregojnë pikërisht vendin ku u vra 22-vjeçari mbrëmë në Vlorë. Gazetari Enrik Mehmeti ka siguruar për BalkanWeb pamjet nga ballkoni i banesës së viktimës. Gëzim Sinomati ishte duke pirë cigare në ballkon kur është qëlluar nga një distancë e afërt me snajper. Policia ka gjetur edhe një makinë të tipit BMW, të djegur në herëndesi të lagjes "24 Maji". Mësohet se rreth 10-15 persona janë dyetur në polici për ngjarjen që ndodhi të dielën në mbrëmje. Ata janë kryesisht familjarë të viktimës, por edhe persona që mund të kenë pare autorin. Në dëshminë e tyre nuk është se kanë treguar dicka reale që mund të ndihmojë për ngjarjen në fjalë. Autori ngjarjes ka qenë thuajse i paduksshëm në kryerjen e këtij krimi.

22-vjeçari Gëzim Sinomati kishte pak kohë që ishte rikthyer në Vlorë në fund të dhjetorit për festat e fundvitit dhe do të largohej sërish në drejtim të Belgjikës. Ai qëndronte i vetëm në banesën në katin e tretë në një pallat në lagjen "Hajro Cakërri" prane bulevardit të Vlorës. Autorët e kanë goditur me snajper nga shumë pranë, ndërsa dyshohet se goditja erdhi nga godinat e banimit shumë pranë shtëpisë së tij, pallate banimi disa katësh një i përfunduar prej kohësh dhe tjetri në ndërtim e sipër. Nga grupi hetimor mësohet se ndaj objektivit është qëlluar vetëm një herë, ndërsa plumbi e ka goditur në kokë, duke gjetur vdekjen e menjëhershme. Ngjarja ndodhur në një zonë të populluar që ka biznese dhe kamera sigurie krahas banesave. Kamerat mund të kenë fiksuar lëvizjet e autorit apo autorëve të mundshëm të ngjarjes. Gjatë momentit kur ndodhi vrasja lagjja "Hajro Cakërri" ka qenë pa drita, ndërsa nuk dihet nëse kjo është një rastësi apo ka të bëj me krimin.

Mjeti i llojit BMW që u gjend i djegur është lënë pranë shinave të trenit në lagjen "24 Maji" në një zonë të mirëmenduar në errësirë, veçmas bllokut të banimit çka tregon se autorët e kanë njohur zonën dhe atentatin e kanë mirëmenduar. Po ashtu bëhet e ditur se brenda mjetit të djegur që mendohet se përdorën autorët, nuk është gjetur arma e krimit.

Ngjarja dyshohet për larje hesapesh. Gëzim Sinomati, është djali i Sokol Sinomatit i njohur me pseudonimin Sokol Buzëderri anëtar i bandës së Gaxhait. Ndaj duket se saga e hakmarrjes dhe përplasjes së bandave vazhdon. Gëzim Sinomati dyshohet i ekzekutuar për llogari të babait të tij, por nuk përjashtohen as prishje e pazareve të drogës. Xhaxhait të viktimës Benard Sinomatit vëllait të Sokolit në 4 janar 2022 i vunë tritolin pikërisht në një automjet poshtë ballkonit të shtëpisë ku ndodhi kjo ngjarje. Edhe Benardi ato kohe sapo hiqte kthyer nga Belgjika. Benard dhe Sokol Sinomati të dy vëllezër, janë figura të njohura për policinë, ndërkohë viktima nuk figuron person me precedent penal.

Policia ka ngritur postoblikun në pikat kyçe të qytetit, por pa mundur të arrestojë apo identifikojë autorët e ngjarjes. Pjesë e kontrolleve kanë qenë edhe strukturat FNSH dhe RENEA.

(BalkanWeb)

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

Etiketa: autori Vlorë vrasia

TË NGJASHME

Plan apo rastësi? E gjithë zona në fert, lagja në Vlorë pa dritë në momentin ku ndodhi vrasja e 22-vjeçarit

08 Janar, 2024

Qëlluan për vdekje me snajper të riun në Vlorë, autorët për të fshehur gjurmët dogjën BMW-në dhe...

08 Janar, 2024

Taboola Feed

Most Computer Owners Don't Know This. Do It Today!
This Could Be the Most Important Tip You Read This Year
OutSyte Driver Updater Sponsored
Click Here

This Knife Stays Sharp For A Lifetime - You'll Never Guess Why
The Knife Expert | Sponsored
Learn More

The housekeepers are furious: this cheap robot is stealing their jobs
Robot Vacs | Sponsored
Learn More

If you own a mouse, you will never turn off your computer again.
PowerMouse Sponsored

This gadget is all the rage! Clean the floor without spending a fortune, it's possible
Robot Vacs | Sponsored
Learn More

Unsold Prefabricated Cabins With Toilet And Bath Cost Almost Nothing! (Take A...
Unsold Prefabricated Cabins | Sponsored
Learn More



This mineral will melt your belly fat fast
Gold Energy Review Shocking | Sponsored

TË FUNDIT NGA KRONIKË

Dhunuan barbarisht 3 të rinjtë shqiptarë, diardhen emrat e 2 prej 5 të arrestuarve në Mal të Zi

08 Janar, 2024

I shkukur prej 20 dhisku/ Gjendet pa shenja jete në rrugë i moshuari në Korçë, çfarë thotë policia

08 Janar, 2024

Të akuzuar për vrasjen e Edmond Papës/ Mbyllen hetimet, dërgohen për gjykim Andrea Bode dhe Albano Velo

08 Janar, 2024

Shtyhet procesi gjyqësor ndaj biznesmenit Rezart Taçi, dhardhet argumentimi i avokatëve

08 Janar, 2024

EMRI/ I shpallur në kërkim për disa ditë, arrestohet 28-vjeçari nga Shkodra

08 Janar, 2024

Vodhën në një qendër tregtare, arrestohet një person në Tiranë, procedohen tre bashkëpunëtorët e tij

08 Janar, 2024

KATEGORIA VIDEO

200 ditë para Lojërave Olimpike, Emmanuel Macron mesazh për francezët brenda pajisteriës: Bëni sport, ju bën mirë për shëndetin

08 Janar, 2024

VIDEO/ Reshje dëbore në qarkun e Korçës, ja si paraqitet situata në jugëlindje të vendit

08 Janar, 2024

VIDEO/ I riu doli në ballkon për të pirë cigare, por u qëllua për vdekje nga një distancë e afërt. Si u eliminua me 1 plumb në kokë nga snajperisti

08 Janar, 2024

Qëlluan për vdekje me snajper të riun në Vlorë, autorët për të fshehur gjurmët dogjën BMW-në dhe...

08 Janar, 2024

Vrasja në Vlorë/ U qëllua për vdekje me snajper, ai i shpëtoi atentatit një vit më parë i riu

07 Janar, 2024

VIDEO/ E rëndë në Vlorë, një 22-vjeçar qëllohet për vdekje me snajper në banesën e tij (Detaje)

07 Janar, 2024

© 2024 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e mbrojtura.